



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 67

3 maj

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 118/2013 datë 18.4.2013	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Londrës për zbatimin e nenit 65 të Konventës Për Patentat Europiane 2975
Ligj nr. 119/2013 datë 18.4.2013	Për dhënien në përdorim të truallit institucioneve arsimore, shëndetësore dhe të përkujdesjes shoqërore 2978
Ligj nr. 120/2013 datë 18.4.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar 2980
Ligj nr. 121/2013 datë 18.4.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar 2982
Ligj nr. 122/2013 datë 18.4.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar 2989
Vendim i Kuvendit nr. 20/2013, datë 25.4.2013	Për emërimin e një anëtari të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) 3000
Vendim i Kuvendit nr. 21/2013, datë 25.4.2013	Për zgjedhjen e zotit Lulzim Lelçaj anëtar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë 3001
Vendim i Kuvendit nr. 22/2013, datë 25.4.2013	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Admir Thanza anëtar i Gjykatës së Lartë 3001
Vendim i Kuvendit nr. 23/2013, datë 25.4.2013	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Tom Ndreca anëtar i Gjykatës së Lartë 3002

Vendim i Kuvendit nr. 24/2013, datë 25.4.2013	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Xhezair Zaganjori Kryetar i Gjykatës së Lartë	3002
Vendim i Kuvendit nr. 25/2013, datë 25.4.2013	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Fatos Lulo anëtar i Gjykatës Kushtetuese	3003
Udhëzim i MTKRS nr. 1, datë 3.5.2013	Për dhënien me qira të monumenteve të kulturës.....	3003

LIGJ
Nr. 118/2013

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN E LONDRËS
PËR ZBATIMIN E NENIT 65 TË KONVENTËS PËR PATENTAT EUROPIANE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Marrëveshjen e Londrës për zbatimin e nenit 65 të Konventës për Patentat Europiane të 17 tetorit 2000, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8127, datë 30.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE
PËR ZBATIMIN E NENIT 65 TË KONVENTËS PËR PATENTAT EUROPIANE

Shtetet palë në këtë marrëveshje,
Në cilësinë e shteteve palë të Konventës për Patentat Europiane e 5 tetorit 1973,
duke konfirmuar dëshirën e tyre për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet shteteve të Europës në fushën e mbrojtjes së shpikjeve;
duke pasur parasysh nenin 65 të Konventës Europiane të Patentave;
duke njohur rëndësinë e objektivit për uljen e kostove që lidhen me përkthimin e patentave europiane;
duke theksuar nevojën për përkrahje të gjerë të këtij objekti;
të vendosur për të kontribuar në mënyrë të efektshme për këtë ulje kostosh,
kanë rëndë dakord për dispozitat e mëposhtme:

Neni 1

Përfshirja nga detyrimi për përkthim

1. Çdo shtet palë i kësaj marrëveshjeje, që ka një gjuhë zyrtare të njëjtë me njërin nga gjuhët zyrtare të Zyrës Europiane të Patentave, heq dorë nga kërkitimi i përkthimit të parashikuar në nenin 65 pika 1 të Konventës Europiane të Patentave.



2. Çdo shtet palë i kësaj marrëveshjeje, që nuk ka një gjuhë zyrtare të njëjtë me njërën nga gjuhët zyrtare të Zyrës Europiane të Patentave, heq dorë nga kërkimi i përkthimit të parashikuar në nenin 65 pika 1 të Konventës Europiane të Patentave, nëse Patenta Europiane është dhënë në gjuhën zyrtare të Zyrës Europiane të Patentave e përcaktuar nga ai shtet, ose nëse përkthimi në këtë gjuhë është depozituar sipas kushteve të përcaktuara në nenin 65 pika 1 të Konventës Europiane të Patentave.

3. Shtete të cilave u referohet pika 2, gëzojnë të drejtën të kërkojnë që pretendimet e përkthyer në një prej gjuhëve të tyre zyrtare të depozitohen sipas kushteve të parashikuara në nenin 65 pika 1 të Konventës Europiane të Patentave.

4. Asnjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje nuk interpretohet si kufizim i së drejtës së shteteve palë në këtë marrëveshje që të heqin dorë nga kërkesat e përkthimit, apo të aplikojnë kërkesa më liberale për përkthimin krahasuar me ato të përcaktuara në pikat 2 dhe 3.

Neni 2

Përkthimi në rast mosmarrëveshjeje

Asnjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje nuk interpretohet si kufizim i së drejtës së shteteve palë në këtë marrëveshje që në rast mosmarrëveshjeje në lidhje me një patentë europiane, të detyrojë pronarin e patentës që me shpenzimet e veta:

a) me kërkesë të një shkelësi të prezumuar, të depozitojë përkthimin e plotë në një gjuhë zyrtare të shtetit ku ka ndodhur shkelja e prezumuar;

b) me kërkesë të gjykatës kompetente apo autoritetit *quasi-gjyqësor* gjatë një procedimi gjyqësor, të depozitojë përkthimin e plotë në një gjuhë zyrtare të shtetit në fjalë.

Neni 3

Nënshkrimi, ratifikimi

1. Kjo marrëveshje është e hapur për t'u firmosur nga të gjitha shtetet palë të Konventës Europiane të Patentave deri më 30 qershor 2001.

2. Kjo marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Qeverisë së Republikës Federale Gjermane.

Neni 4

Aderimi

Me mbarimin e afatit për nënshkrimin e marrëveshjes të përcaktuar në nenin 3 pika 1, kjo marrëveshje është e hapur për aderim nga çdo shtet palë i Konventës Europiane të Patentave dhe nga çdo shtet që gëzon të drejtën e aderimit në këtë konventë. Instrumentet e aderimit depozitohen pranë Qeverisë së Republikës Federale Gjermane.

Neni 5

Ndalimi i rezervimeve

Asnjë shtet palë i kësaj marrëveshjeje nuk lejohet të bëjë rezervime të lidhura me të.

Neni 6

Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit të katërt pas depozitimit të instrumentit të fundit të ratifikimit apo pas aderimit nga tetë shtete palë në Konventën Europiane të Patentave, përfshirë tri shtetet që në vitin 1999 kishin në fuqi numrin më të madh të patentave.

2. Çdo ratifikim apo aderim pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, fillon efektet në ditën e parë të muajit të katërt pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit apo të aderimit.

Neni 7

Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje të pakufizuar.

Neni 8

Prishja e marrëveshjes

Çdo shtet palë i kësaj marrëveshjeje mund ta prishë atë në çdo kohë, pasi të kenë kaluar tre vjet nga hyrja në fuqi e saj. Njoftimi për prishjen e marrëveshjes depozitohet pranë Qeverisë së Republikës Federale Gjermane. Prishja e marrëveshjes fillon efektet një vit pas datës së marrjes së këtij njoftimi. Prishja nuk cenon të drejtat që janë fituar në kuadër të kësaj marrëveshjeje që përpara fillimit të efekteve të prishjes.

Neni 9

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje janë patentat europiane, dhënia e të cilave është publikuar në Buletinin e Patentave Europiane pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes në shtetin në fjalë.

Neni 10

Gjuhët e marrëveshjes

Kjo marrëveshje e hartuar në një kopje origjinale të vetme, në gjuhën angleze, frënge dhe gjermane, depozitohet pranë Qeverisë së Republikës Federale Gjermane dhe të tria tekstet janë njëjloj autentike.

Neni 11

Përcjellja e kopjeve të marrëveshjes dhe njoftimet

1. Qeveria e Republikës Federale Gjermane përpilon kopje të certifikuara autentike të kësaj marrëveshjeje dhe ua përcjell ato qeverive të të gjitha shteteve nënshkruese dhe aderuese.

2. Qeveria e Republikës Federale Gjermane njofton qeveritë e shteteve të përcaktuara në pikën 1:

a) për çdo nënshkrim;

b) për depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi ose aderimi;

c) për datën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje;

d) për çdo prishje të marrëveshjes të marrë sipas nenin 8 dhe datën kur fillojnë efektet e prishjes.

3. Qeveria e Republikës Federale Gjermane e regjistron këtë Konventë pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, të plotfuqishmit e autorizuar paraqitën plotfuqitë e tyre dhe e nënshkruan marrëveshjen pasi konstatuan se është formuluar në formën e duhur.

Nënshkruar në Londër, më 17 tetor 2000, në një kopje origjinale në gjuhët angleze, frënge dhe gjermane, ku të tria tekstet janë njëjloj autentike.



LIGJ
Nr. 119/2013

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË TRUALLIT INSTITUCIONEVE ARSIMORE,
SHËNDETËSORE DHE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

1. Qëllimi i këtij ligji është krijimi i fondit “Truall për shkollë, spitale, qendra komunitare të kujdesit shëndetësor dhe qendra të përkujesjes shoqërore”, më poshtë i quajtur “fondi”, si dhe përcaktimi i organeve përgjegjëse për menaxhimin e tij, në përputhje me qëllimin e krijimit.

2. Fondi, sipas pikës 1 të këtij neni, krijohet nga pronat e paluajtshme të shtetit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, dhe nga dhurimet e ligjshme.

Neni 2

1. Burimi i krijimit të fondit “Truall për shkollë, spitale, qendra komunitare të kujdesit shëndetësor dhe qendra të përkujesjes shoqërore” janë sipërfaqet e trojeve në pronësi të shtetit, që ndodhen brenda vijave kufizuese të qyteteve apo qendrave të banuara.

2. Fondi planifikohet nga grupi teknik ndërinstitutional, i ngritur me urdhër të Kryeministrit, me përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

3. Fondi dhe ndryshimet në të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Fondi menaxhohet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Kriteret dhe procedurat për dhënie në përdorim të këtij trualli, në formën e huapërdorjes, me çmim 1 euro, me afat 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet dhe sipërfaqe toke jo më shumë se 2 hektarë, institucioneve arsimore, shëndetësore dhe qendrave të përkujesjes shoqërore, publike ose private, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimeve të përbashkëta të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe, përkatësisht, sipas qëllimit të përdorimit të truallit, Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Neni 4

1. Institucioneve të arsimit, publik dhe privat, u jepet për përdorim truall nga ky fond:

a) për të ndërtuar shkolla;

b) për të ndërtuar godina vetëm në funksion të procesit mësimor dhe akademik;

- c) për të ndërtuar kampuse universitare;
- ç) për të instaluar laboratorë kërkimorë-shkencorë;
- d) për të krijuar ambiente të praktikave mësimore;
- dh) për të krijuar biblioteka universitare të standardeve ndërkombëtare.

2. Institucioneve të arsimit privat u jepet për përdorim tokë për të zhvilluar institucionin, kur:

- a) është kryer licencimi i institucioneve të arsimit parauniversitar, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) është kryer licencimi dhe akreditimi institucional i institucionit të arsimit të lartë, sipas procedurës së parashikuar nga legjislacioni i arsimit të lartë në fuqi;
- c) institucioni i arsimit të lartë bashkëpunon me universitete ndërkombëtare të njohura;
- ç) investimi i planifikuar për institucionin e arsimit të lartë është, së paku, 2 herë më i lartë se vlera e tokës së dhënë në përdorim;
- d) institucioni i arsimit të lartë, në planin e zhvillimit, planifikon edhe programe studimi profesionale, me formim të theksuar praktik, programe të studimeve jouniversitare profesionale, pas arsimit të mesëm 2-vjeçar, me jo më pak se 120 kredite, dhe programe studimi universitare 3-vjeçare të integruara me praktikën;
- dh) tarifat e shkollimit të ofruara janë nën mesataren e tregut;
- e) ofrojnë bursa studimi për fëmijët/studentët e shtresave sociale në nevojë dhe nxënësit/studentët ekselentë.

Neni 5

1. Institucioneve shëndetësore, publike apo private, u jepet për përdorim truall nga ky fond:
 - a) për të ndërtuar spitale;
 - b) për të ndërtuar qendra komunitare të kujdesit shëndetësor;
 - c) për të krijuar ambiente të riaftësimit fizik dhe mendor.
2. Institucioneve shëndetësore të përmendura në pikën 1 të këtij neni u jepet për përdorim tokë për të zhvilluar institucionin, nëse:
 - a) janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi;
 - b) krijohen në përputhje me politikat shëndetësore të rritjes së aksesit për kujdes shëndetësor të grupeve të popullatës në mënyrë të drejtë dhe të barabartë;
 - c) qendrat komunitare ofrojnë shërbime të shëndetit mendor;
 - ç) qendrat komunitare ofrojnë shërbime të kujdesit paliativ;
 - d) qendrat komunitare ofrojnë shërbime riaftësimi për të sëmurë me autizëm, prapambetje mendore, paaftësi fizike, vartësi nga substancat (droga, alkooli, duhani).

Neni 6

1. Institucioneve të përkujdesjes shoqërore, publike dhe private, u jepet për përdorim truall nga ky fond:
 - a) për të ndërtuar qendra të përkujdesjes për të moshuarit, fëmijët në nevojë, fëmijët jetimë, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, të rinjtë në nevojë, romët, gratë kryefamiljare;
 - b) për të ndërtuar godina për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara, paraplegjikë e tetraplegjikë, të verbërve, fëmijëve autikë, përdoruesve të drogës, viktimave të trafikut dhe viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, të miturve me dënime alternative etj.;
 - c) për të ndërtuar qendra multifunksionale për kategoritë në nevojë.



2. Institucioneve të përkujdesjes shoqërore private u jepet për përdorim tokë për të zhvilluar institucionin, nëse:

a) është kryer licencimi i tyre, sipas procedurës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi;

b) bashkëpunojnë me organet e pushtetit vendor për hapjen e qendrave të reja komunitare ose zgjerimin e atyre ekzistuese, për kategoritë në nevojë;

c) investimi i planifikuar është, së paku, 2 herë më i lartë se vlera e tokës së dhënë në përdorim;

ç) ofrojnë shërbime të përkujdesjes sociale, sipas standardeve të miratuara, dhe pa pagesë për kategoritë në nevojë ose me tarifa më të ulëta se tarifat mesatare të tregut.

Neni 7

1. Dhënia në përdorim e këtij trualli institucioneve arsimore, shëndetësore, qendrave të përkujdesjes shoqërore, publike ose private, miratohet paraprakisht nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, të ngarkuar me funksionin e menaxhimit të këtij fondi truall me pronësi publike. Kuvendi i Shqipërisë ratifikon kontratën e dhënies në përdorim të truallit.

2. Institucioni publik ose privat, të cilit i është dhënë në përdorim truall nga ky fond, nuk mund ta ndryshojë në asnjë rast destinacionin e përdorimit dhe statusin juridik të tyre. Në rast ndryshimi, trualli dhe investimi i bërë në të i kthehen shtetit.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8128, datë 30.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ Nr. 120/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008 “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 4, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë dhe caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm^3 x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 12,5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit. 18 për qind e të ardhurave vjetore nga kjo takse i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësisve të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësisve të qeverisjes vendore.”.

Neni 2

Në nenin 9, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Falen të gjitha detyrimet e prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor për mjetet e sekuestruara apo të konfiskuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilat i kalojnë në administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për qëllime përdorimi apo rishitjeje.”.

Neni 3

Dispozita kalimtare

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjithë pronarët e mjeteve, që nuk kanë paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura, paguajnë sipas këtij ligji. Në rast se pagesa bëhet brenda datës 30 qershor 2013, ata përjashtohen edhe nga penalitetet për vonesë në pagesën e taksave. Aplikimi i penalitetit për vonesë në pagesën e taksave, për të gjitha mjetet, që u ka kaluar afati i vlefshmërisë së taksave, pavarësisht kur e kanë kryer pagesën e taksave, fillon nga data 1 janar 2014.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.4.2013

Shpallur me dekretin nr. 8129, datë 30.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani



LIGJ
Nr. 121/2013

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7850, DATË 29.7.1994 “KODI CIVIL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 shkronja “d” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Neni 318 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 318

Koha e çeljes së trashëgimisë

Trashëgimia çelet kur vdes trashëgimlënësi.

Në rastin e shpalljes së personit të vdekur, trashëgimia çelet ditën kur, sipas vendimit gjyqësor, personi konsiderohet i vdekur.”.

Neni 2

Pas nenit 318 shtohen nenet 318/1 dhe 318/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 318/1

Vendi i çeljes së trashëgimisë

Trashëgimia çelet në vendin ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, trashëgimia çelet në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj.

Neni 318/2

Ligji i zbatueshëm

Trashëgimia rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur.”.

Neni 3

Neni 333 ndryshohet si më poshtë:

¹ Përafuar plotësisht me direktivën e Këshillit nr. 86/653/EEC të datës 18 dhjetor 1986 “Për koordinimin e ligjeve të shteteve anëtare që kanë të bëjnë me agjentët tregtarë të vetëpunësuar”, Nr. CELEX 31988L0653.

“Neni 333

Heqja dorë nga trashëgimia

Heqja dorë nga trashëgimia duhet të bëhet me deklaratë të shkruar, që regjistrohet te noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, ose me deklaratë noteriale të redaktuar nga noteri.

Heqja dorë mund të bëhet edhe me anë të një përfaqësuesi të pajisur me prokurë të posaçme.

Pas regjistrimit të heqjes dorë nga trashëgimia, noteri kryesisht lëshon një dëshmi të re trashëgimie, ku pasqyrohet ndryshimi në rrethin e trashëgimtarëve, si dhe pjesët e tyre takuese, të cilën ia dërgon personit që ka kërkuar lëshimin e dëshmisë fillestare të trashëgimisë.”.

Neni 4

Në nenin 336, fjalët “grykata e rrethit ku” zëvendësohen me fjalët “noteri i njësisë vendore”.

Neni 5

Neni 343 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 343

Masat për sigurimin e pasurisë trashëgimore

Kur shihet e nevojshme të mbrohen interesat e trashëgimtarëve, të personave që mund të përfitojnë nga disponimet me testament, të kreditorëve të trashëgimlënësit ose të shtetit, noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, kryesisht, ose me kërkesën e çdo të interesuari, bën inventarin e pasurisë trashëgimore.

Noteri që bën inventarin mund të caktojë një person si ruajtës të pasurisë trashëgimore.

Derisa të mos jenë hequr masat e mësipërme, trashëgimtari që mund të ketë filluar nga administrimi i pasurisë trashëgimore, nuk mund ta tjetërsojë atë veçse me lejen e gjykatës.”.

Neni 6

Në nenin 344 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) fjalët “grykata e rrethit ku” zëvendësohen me fjalët “noteri i njësisë vendore ku”;

b) paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Shkurtimi i aktit noterial të emërimit të kujdestarit shpallet në Fletoren Zyrtare.”.

Neni 7

Neni 348 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 348

Dëshmia e trashëgimisë

Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgimi caktohen në dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga noteri, pas paraqitjes së certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod dhe në ligjin për noterinë.

Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri i njësisë vendore ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, dëshmia



e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri që ushtron veprimtarinë në njësinë vendore ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj.

Dëshmia e trashëgimisë testamentare lëshohet nga noteri, pranë të cilit është redaktuar testamenti me akt noterial, apo është depozituar për ruajtje testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm. Në rast se i njëjti trashëgimlënës ka lënë më shumë se një testament, dëshmia e trashëgimisë testamentare lëshohet nga noteri, pranë të cilit është redaktuar apo depozituar për ruajtje testamenti i fundit.

Dëshmia e trashëgimisë testamentare, në rastet kur testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm nuk janë dërguar për ruajtje pranë noterit, lëshohet nga noteri që ushtron veprimtarinë në njësinë vendore ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, dëshmia e trashëgimisë testamentare, në rastet kur testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm nuk janë dërguar për ruajtje pranë noterit, lëshohet nga noteri që ushtron veprimtarinë në njësinë vendore ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj.

Dëshmia e trashëgimisë redaktohet në numër të barabartë me trashëgimtarët e përcaktuar në të. Noteri, në momentin e redaktimit, lëshon dëshminë e trashëgimisë në numër të barabartë me kërkuesit, ndërsa kopjet e tjera të redaktuara ruhen nga noteri dhe mund të tërhiqen nga trashëgimtarët e tjerë, sipas kërkesës së tyre.

Rregullat e hollësishme për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, si dhe për regjistrimin e testeve të testamenteve përcaktohen nga ligji për noterinë.”.

Neni 8

Neni 354 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 354

Pjesëtimi i pasurisë trashëgimore bëhet me marrëveshje midis trashëgimtarëve, e cila miratohet me akt noterial.

Nëse trashëgimtarët nuk bien dakord për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore, noteri, mbi bazën e parimit të paanësisë, si dhe duke mbajtur në konsideratë rregullat e pjesëtimit të pasurisë, sipas këtij Kodi, i ofron trashëgimtarëve mundësitë ligjore për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore dhe arritjen e një marrëveshjeje midis tyre. Në këtë rast noteri i sqaron ata për të drejtat dhe detyrat, si dhe i paralajmëron për pasojat që vijnë nga nënshkrimi i marrëveshjes, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tyre nga mosdijenja e ligjit.

Kur trashëgimtarët nuk bien dakord edhe me zgjidhjet e ofruara nga noteri, pjesëtimi i pasurisë trashëgimore bëhet nga gjykata kompetente për shqyrtimin e padive që rrjedhin nga trashëgimia.”.

Neni 9

Në nenin 546, në fund të paragrafit të dytë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Dispozitat për pengun nuk zbatohen edhe në rastet e marrëveshjeve të kolateralit financiar, të cilat rregullohen me ligj të veçantë.”.

Neni 10

Kreu XIII i titullit II të pjesës V ndryshohet si më poshtë:

**“KREU XIII
AGJENCIA**

Neni 950
Dispozita të përgjithshme

Me kontratën e agjencisë, njëra palë merr përsipër, në mënyrë të vazhdueshme dhe me shpërblim, që të lidhë kontratat në një zonë të caktuar, për llogari të palës tjetër.

Secila palë ka të drejtë të marrë nga pala tjetër një kopje të kontratës të nënshkruar prej saj.

Neni 951
Ekskluziviteti

Pala porositëse nuk mund të ketë njëkohësisht më shumë se një agjent në të njëjtën zonë apo për të njëjtin grup klientësh dhe për të njëjtën fushë të veprimtarisë.

Gjithashtu, agjenti nuk mund të trajtojë njëkohësisht, në të njëjtën zonë apo për të njëjtin grup klientësh dhe për të njëjtën fushë, kontratat e disa ndërmarrjeve në konkurrencë midis tyre.

Neni 952
Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Agjenti tregtar, në ushtrimin e aktiviteteve të tij, duhet të kujdeset për interesat e porositësit dhe të veprojë me korrektësi dhe mirëbesim për të përmbushur detyrimet e tij. Agjenti tregtar duhet në veçanti:

a) të përpiqet për të negociuar dhe, kur është rasti, të lidhë kontratat për të cilat është ngarkuar;

b) t'i njoftojë porositësit çdo informacion të nevojshëm që ai disponon;

c) të zbatojë udhëzimet e arsyeshme të dhëna nga porositësi.

Porositësi, në marrëdhëniet e tij me agjentin tregtar, duhet të veprojë me korrektësi dhe mirëbesim për të përmbushur detyrimet e tij. Porositësi duhet në veçanti:

a) të vërë në dispozicion të agjentit tregtar dokumentacionin e nevojshëm që ka të bëjë me kontratat në fjalë;

b) t'i sigurojë agjentit tregtar informacionet e nevojshme për përmbushjen e kontratës së agjencisë, veçanërisht të njoftojë agjentin tregtar në një afat kohor të arsyeshëm, sapo ai parashikon që volumi i kontratave do të jetë në mënyrë të dukshme më i ulët se ai, të cilin agjenti tregtar do të priste normalisht.

Porositësi, gjithashtu, duhet të informojë agjentin tregtar në një afat kohor të arsyeshëm, për pranimin, refuzimin ose mosekzekutimin e një kontrate që agjenti tregtar ka siguruar për porositësin.

Palët nuk mund të shmangen nga zbatimi i dispozitave të këtij neni.

Neni 953
Shpërblimi i agjentit tregtar

Në mungesë të ndonjë marrëveshjeje ndërmjet palëve mbi këtë çështje, agjenti tregtar ka të drejtën e shpërblimit që agjentët tregtarë, të caktuar për kontratat që formojnë objektin e kontratës së tij të agjencisë, përfitojnë zakonisht në vendin ku ai ushtron aktivitetin e tij. Nëse nuk ekziston një praktikë e tillë zakonore, agjenti tregtar duhet të ketë të drejtën për një shpërblim të arsyeshëm, duke pasur parasysh të gjitha aspektet e kontratës.



Konsiderohen si shpërblim i agentit të gjitha elementet e pagesës që përfiton ai dhe që ndryshojnë sipas numrit apo vlerës së veprimeve tregtare.

Në mungesë të zakoneve të tilla, agjenti tregtar ka të drejtën e një shpërblimi të arsyeshëm, që merr parasysh të gjitha elementet që kanë të bëjnë me veprimin.

Neni 954

Agjenti tregtar ka të drejtën e shpërblimit për kontratat e përfunduara gjatë periudhës së kontratës së agjencisë:

a) nëse kontrata është përfunduar si rezultat i veprimit të tij;

b) nëse kontrata është përfunduar me një të tretë, të cilin ai kishte fituar më parë si klient për kontrata të të njëjtit lloj;

c) nëse ai ka një të drejtë ekskluzive për një zonë gjeografike të caktuar ose një grupi klientësh dhe kontrata është kryer me një klient që i përket kësaj zone dhe/ose këtij grupi.

Për një kontratë të përfunduar pas përfundimit të kontratës së agjencisë, agjenti tregtar ka të drejtën e shpërblimit:

a) nëse kontrata i detyrohet kryesisht përpjekjeve të tij të kryera gjatë kontratës së agjencisë, pavarësisht se kontratat janë përfunduar në një afat kohor të arsyeshëm, pas mbarimit të kontratës së agjencisë; ose

b) nëse porosia e një të treti ka qenë marrë nga porositësi ose nga agjenti tregtar para mbarimit të kontratës së agjencisë.

Agjenti tregtar nuk ka të drejtën e shpërblimit nëse ai i detyrohet agentit tregtar paraardhës, përveç kur nuk rezulton nga rrethanat që është e drejtë që shpërblimi të ndahet mes agjentëve tregtarë.

Shpërblimi bëhet i pagueshëm në momentin dhe në masën kur paraqitet një nga rrethanat e mëposhtme:

a) pala porositëse ka ekzekutuar kontratën;

b) pala porositëse duhej të kishte ekzekutuar kontratën, në përputhje me marrëveshjen e lidhur me palën e tretë;

c) pala e tretë ka ekzekutuar kontratën.

Shpërblimi merret më vonë kur një i tretë ka ekzekutuar pjesën e tij të kontratës apo do të duhej ta kishte ekzekutuar, nëse pala porositëse do të kishte ekzekutuar pjesën e tij të kontratës.

Shpërblimi paguhet jo më vonë se dita e fundit e muajit që vjen pas tremujorit, në të cilin bëhet i kërkueshëm.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i kësaj dispozite në dëm të agentit tregtar.

Neni 955

E drejta për shpërblim mund të shuhet vetëm në qoftë se dhe në masën në të cilën:

a) vendoset se kontrata ndërmjet të tretit dhe porositësit nuk do të ekzekutohet; dhe

b) mosekzekutimi nuk i detyrohet rrethanave që i ngarkohen porositësit.

Agjenti tregtar duhet të rikthejë shpërblimin që ka marrë nëse e drejta për marrjen e tij nuk ekziston më.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i kësaj dispozite në dëm të agentit tregtar.

Neni 956

Pala porositëse i dorëzon agentit një ekstrakt llogarie të shpërblimeve që i takon këtij, jo më vonë se ditën e fundit të muajit që vjen pas tremujorit, në të cilin bëhet i pagueshëm. Ekstrakt llogaria duhet të tregojë elementet thelbësore, në bazë të të cilave është kryer përlllogaritja e shpërblimeve.

Agjenti ka të drejtë që t'i jepen të gjitha informacionet, në veçanti një ekstrakt i librave kontabël, që janë në dispozicion të porositësit, të nevojshme për të verifikuar shumën e shpërblimeve të paguara.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i kësaj dispozite në dëm të agjentit tregtar.

Neni 957

Mbarimi dhe zgjidhja e kontratës së agjencisë

Kontrata e agjencisë me kohë të caktuar kur vazhdon të zbatohet nga palët edhe pas mbarimit të kohës, shndërrohet në kontratë me afat të pacaktuar. Nëse kontrata e agjencisë është me kohë të pacaktuar, secila nga palët mund të tërhiqet nga kjo kontratë, duke njoftuar paraprakisht palën tjetër brenda një afati të caktuar.

Afati i njoftimit paraprak nuk mund të jetë më i shkurtër se një muaj për vitin e parë të kohëzgjatjes së kontratës, dy muaj për vitin e dytë të filluar, tre muaj për vitin e tretë të filluar, 4 muaj për vitin e katërt, 5 muaj për vitin e pestë dhe 6 muaj për vitin e gjashtë dhe për të gjitha vitet në vazhdim. Nëse palët merren vesh për afate paralajmërimi më të gjata, afati i paralajmërimit që duhet të respektojë pala porositëse nuk duhet të jetë më i shkurtër se afati që duhet të respektojë agjenti. Përveç kur me marrëveshje është caktuar ndryshe nga palët, mbarimi i afatit të paralajmërimit duhet të përkohet me ditën e fundit të muajit kalendarik. Të njëjtat rregulla zbatohen dhe për kontratën e agjencisë me kohë të përcaktuar, të shndërruar në kontratë me kohë të papërcaktuar, me kushtin që në llogaritjen e afatit të paralajmërimit duhet të mbahet parasysh afati i mëparshëm.

Në mbarim të kontratës së agjencisë, porositësi detyrohet t'i paguajë agjentit një shpërblim në masën dhe nëse:

a) agjenti ka siguruar klientë të rinj për palën porositëse ose i ka zhvilluar dukshëm kontratat me klientët ekzistues dhe pala porositëse ka ende përfitime të konsiderueshme që rrjedhin nga kontratat me këta klientë;

b) pagesa e këtij shpërblimi është e drejtë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, sidomos shpërblimin që agjenti tregtar humbet dhe që rezultojnë nga veprimet me këta klientë, si dhe nga kufizimi i aktiviteteve të tij profesionale që i detyrohen ekzistencës së një klauzole të moskonkurrencës.

Shuma e shpërblimit nuk mund të tejkalojë një vlerë të barabartë me shpërblimin vjetor të llogaritur nga mesatarja vjetore e shpërblimeve të marra nga agjenti tregtar gjatë pesë viteve të fundit. Nëse kontrata përfshin një afat më të shkurtër se pesë vjet, shpërblimi llogaritet mbi mesataren e periudhës së kontratës. Përfitimi i shpërblimit nuk e përjashton agjentin nga e drejta për shpërblimin e mundshëm të dëmeve.

Agjenti tregtar ka të drejtë për shpërblimin e dëmit që ka pësuar si rezultat i përfundimit të marrëdhënieve me palën porositëse.

Ky dëm rezulton veçanërisht kur mbarimi i kontratës ka ndodhur në kushte:

a) të cilat shmangin agjentin tregtar nga shpërblimi që mund të kishte fituar me përmbushjen në mënyrën e duhur të kontratës, duke i siguruar në të njëjtën kohë porositësit përfitime të konsiderueshme të lidhura me veprimtarinë e agjentit tregtar; dhe/ose

b) të cilat nuk i kanë mundësuar agjentit që të rimbursojë kostot dhe shpenzimet që ka bërë për përmbushjen e kontratës, sipas udhëzimeve të porositësit.

E drejta për shpërblim lind, gjithashtu, edhe kur kontrata e agjencisë përfundon si rezultat i vdekjes së agjentit tregtar dhe mund të kërkohet nga trashëgimtarët e tij. Agjenti tregtar humbet të drejtën për shpërblim nëse, brenda një viti nga mbarimi i kontratës, nuk i komunikon porositësit qëllimin për të mbrojtur të drejtat e tij.



Neni 958

Nuk paguhet shpërblim kur:

- a) pala porositëse e zgjidh kontratën për shkak të një mospërmbushjeje që i atribuohet agjentit, e cila justifikon një zgjidhje të menjëhershme të kontratës;
- b) agjenti zgjidh kontratën, përveç rastit kur përfundimi justifikohet nga rrethanat që i atribuohen porositësit, ose për shkak të moshës, paaftësisë ose sëmundjes së agjentit tregtar, për të cilat atij nuk mund t'i kërkohet, në mënyrë të arsyeshme, vazhdimi i veprimtarisë;
- c) agjenti nuk përmbush personalisht të drejtat dhe detyrimet që ai ka në bazë të kontratës së agjencisë, por ia kalon ato një pale të tretë.

Neni 959

Palët nuk mund të shmangin, para mbarimit të kontratës, zbatimin e neneve 957 dhe 958 në dëm të agjentit tregtar.

Neni 960

Marrëveshja që parashikon një kufizim të aktiviteteve profesionale të agjentit tregtar pas përfundimit të kontratës quhet klauzolë e moskonkurrencës.

Marrëveshja e moskonkurrencës është e vlefshme kur bëhet me shkrim. Ajo duhet t'i përkasë një zone gjeografike ose grupi të klientëve, të besuar agjentit tregtar, si dhe llojin e kontratave, për të cilat agjenti tregtar kishte përfaqësimin, sipas kontratës së agjencisë.

Klauzola e moskonkurrencës është e vlefshme për një periudhë jo më shumë se 2 vjet nga dita e përfundimit të kontratës.

Neni 961

Marrëveshja e garancisë së nënshkruar nga agjenti

Një marrëveshje, me anë të së cilës agjenti garanton që një klient do të paguajë çmimin e mallrave që përbëjnë objektin e kontratës, të cilën e ka negociuar apo përfunduar ai, është e vlefshme vetëm nëse dhe për aq sa ajo është bërë me shkrim, mbulon vetëm kontratat e specifikuar shprehimisht në marrëveshje dhe është e arsyeshme për sa i përket interesave të palëve, sidomos për sa i përket shumës së shpërblimit që përfiton agjenti. Në çdo rast shuma e vendosur si garanci nuk mund të jetë më e madhe se shpërblimi që agjenti do të përfitonte prej kësaj kontrate.”.

Neni 11

Dispozitë kalimtare

Dispozitat për trashëgiminë janë të zbatueshme vetëm për kërkesat për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, të bëra pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Çështjet gjyqësore me objekt “kërkesë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë” do të vazhdojnë të shqyrtohen nga gjykata kompetente, sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesës.

Dispozitat mbi agjencinë janë të zbatueshme për kontratat e agjencisë, të lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 shtator 2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8130, datë 30.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 122/2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8116, DATË 29.3.1996 “KODI I
PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 shkronja “d” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 35 paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Gjykata e Lartë gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë të gjitha çështjet që, sipas këtij neni, në gjykatën e shkallës së parë gjykohen nga një gjyqtar. Çështjet e tjera gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Gjykata e Lartë gjykon në kolegje të bashkuara me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve, çështjet e parashikuara shprehimisht në dispozita të tjera të këtij Kodi.”.

Neni 2

Në nenin 63, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Gjykata e Lartë shqyrton ankimin në dhomë këshillimi, në kolegje, me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë dhe shprehet me vendim të arsyetuar jo më vonë se tridhjetë ditë nga momenti i depozitimit të ankesës.”.

Neni 3

Në nenin 64, në fund të paragrafit të dytë shtohen fjalët “sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin e dytë të nenit 63 të këtij Kodi.”.



Neni 4

Neni 75 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 75

Kompetenca për shqyrtimin e kërkesës

Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve shqyrtohet në seancë nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë. Ndaj vendimit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar.

Për kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit të gjykatës së apelit vendos një trup gjykues prej 3 gjyqtarësh i kësaj gjykate, i ndryshëm nga ai, të cilit i përket gjyqtari që kërkohet të përjashtohet. Vendimi është i formës së prerë.

Për kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë vendos një kolegji prej 3 gjyqtarësh i kësaj gjykate, i ndryshëm nga ai, të cilit i përket gjyqtari që kërkohet të përjashtohet. Vendimi është i formës së prerë.

Nuk pranohet kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve të caktuar për të vendosur mbi përjashtimin.”.

Neni 5

Në nenin 77 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Sekretari regjistron çështjet, formon fashikujt gjyqësorë, duke futur atje dokumente ose kopje të tyre të vërtetuara sipas ligjit dhe shënon menjëherë datën e depozitimit, i ruan ato, përpilon komunikimet dhe njoftimet e parashikuara nga ligji ose nga gjykata dhe detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor.”.

b) Pas paragrafit të tretë, shtohet paragrafi i katërt me këtë përmbajtje:

“Sekretari lëshon, kundrejt pagesës, kopje të akteve të përpiluara, të regjistrimeve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive, transkripte të plota ose të pjesshme të këtyre të fundit, si dhe ekstrakte autentike të akteve të përpiluara me shtypshkrim apo dorëshkrim.”.

Neni 6

Neni 118 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 118

Procesverbali

Kryetari i seancës duhet të sigurohet që të mbahet procesverbal nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv për seancën gjyqësore, si dhe për çdo veprim tjetër procedural gjyqësor që zhvillohet jashtë seance. Nëse nuk është e mundur që procesverbali të mbahet nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, ai mbahet duke bërë një përmbledhje të saktë me shtypshkrim apo dorëshkrim.

Procesverbali duhet të tregojë:

- a) vendin ku zhvillohet veprimi procedural gjyqësor;
- b) kohën e zhvillimit të veprimit procedural gjyqësor;
- c) përbërjen e trupit gjykues dhe emrin e sekretarit të gjykatës;
- ç) gjenealitetet e pjesëmarrësve në gjykim; dhe
- d) personat e thirrur, që nuk janë paraqitur, si dhe, nëse dihet, arsye të mungesës së tyre.

Procesverbali duhet të përshkruajë veprimet procedurale të kryera gjatë gjykimit dhe të pasqyrojë fjalë për fjalë:

- a) të gjitha kërkimet dhe kundërshtimet e palëve dhe të personave të tretë;
- b) përmbledhjen e saktë të çdo shpjegimi dhe pretendimi me shkrim të paraqitur nga pala;
- c) pyetjet dhe thëniet e personave që marrin pjesë në gjykim, duke përfshirë dëshmitarët dhe ekspertët;
- ç) provat e marra, duke përfshirë përmbajtjen e provave me shkresë që janë paraqitur, të shiritave të magnetofonit, diapozitivave e filmave;
- d) të gjitha vendimet dhe urdhrat që ka dhënë gjykata gjatë gjykimit; dhe
- dh) të gjitha pretendimet përfundimtare të palëve.

Në rast se procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim, dhe një nga palët kërkon që pjesë nga thëniet e palës tjetër të përfshihen në procesverbal, gjykata duhet ta marrë parasysh këtë kërkesë.

Nëse procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim, ai nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga sekretari dhe në fund të dokumentit nga kryetari i seancës, menjëherë pas seancës, dhe përfshihet në dosjen gjyqësore.

Procesverbali është pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore dhe ruhet për aq kohë sa edhe vetë dosja. Rregullat e hollësishme për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit përcaktohen me urdher të Ministrisë të Drejtësisë.”.

Neni 7

Pas nenit 118 shtohet neni 118/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 118/1

Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive

Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive përgatitet nga sekretari gjyqësor, ose teknikë të kontraktuar nga gjykata dhe që veprojnë nën mbikëqyrjen e sekretarit gjyqësor.

Transkriptimi i procesverbalit bëhet në rastet kur:

- a) kërkohet nga anëtarët e trupit gjykues;
- b) kërkohet me shkrim nga palët në gjykim ose persona të tjerë të interesuar dhe kjo kërkesë miratohet nga kryetari i seancës gjyqësore, pasi paguhen tarifat e vendosura për këtë qëllim, e cila përcaktohet me urdher të Ministrisë të Drejtësisë.

Transkriptimi i regjistrimit mund të bëhet për të gjitha seancat e një çështjeje, për seanca të veçanta ose për pjesë të shkëputura prej tyre, sipas kërkesës së personit që kërkon transkriptimin.

Transkriptimi mund të kërkohet edhe para se gjykata të ketë dhënë vendimin për çështjen.

Transkriptimi i bashkëngjitet dosjes gjyqësore pa cenuar vlefshmërinë e procesverbalit të mbajtur sipas nenit 118 të këtij Kodi.”.

Neni 8

Neni 128 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 128

Njoftimi i akteve

Njoftimi i akteve bëhet sipas mënyrave të parashikuara në këtë kre. Gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues të çështjes kujdeset dhe kontrollon procesin e njoftimit, që kryhet nga nëpunësit e administratës gjyqësore të caktuar për realizimin e tij.”.



Neni 9

Neni 129 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 129 Thirrja në gjykatë

Thirrja në gjykatë bëhet nëpërmjet njoftimit të letërthirrjes, e cila duhet të përmbajë gjykatën që e ka nxjerrë, emrin, mbiemrin e personit të thirrur, kohën e vendin e seancës gjyqësore, mosmarrëveshjen për të cilën thirret, si dhe pasojat ligjore në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në gjykatë.

Gjykata, kur e çmon të dobishme dhe kur pala ka dhënë pëlqimin paraprak, urdhëron që thirrja në gjykatë të bëhet nëpërmjet njoftimit me mjete të komunikimit elektronik, sipas rregullave të përcaktuara në këtë kre.”.

Neni 10

Neni 130 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 130 Rregullat e njoftimit shkresor të akteve

Njoftimi shkresor bëhet nëpërmjet dorëzimit nga nëpunësi gjyqësor ose shërbimi postar i letërthirrjes ose akteve të tjera që duhet t’i njoftohen personit të thirrur, kudo ku ai gjendet.

Në rastin e personave që ndodhen në shërbim në ushtri, njoftimi u bëhet me anë të komandës së repartit nga i cili varen.

Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve.

Në rastin e personave juridikë privatë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet përfaqësuesit ose personit të ngarkuar për të marrë aktet dhe, në mungesë të tyre, një personi tjetër që punon në këtë qendër të personit juridik.

Në rastet kur njoftimi shkresor bëhet nëpërmjet shërbimit postar, nëpunësi gjyqësor shënon mbi origjinalin dhe mbi kopjen e njoftimit edhe zyrën e postës, me anë të së cilës i është dërguar akti marrësit, me dërgesë të porositur. Dëftesa e marrjes në dorëzim duhet t’i bashkohet origjinalit të aktit dhe përfshihet në dosjen gjyqësore.

Në qoftë se personi i thirrur refuzon marrjen e njoftimit, nëpunësi gjyqësor ose punonjësi i shërbimit postar bën shënimin përkatës në aktin objekt njoftimi dhe, kur është e mundur, e vërteton me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm. Në këtë rast, njoftimi duhet konsideruar i përfunduar.”.

Neni 11

Në nenin 131 bëhen ndryshimet si më poshtë:

- a) Në paragrafin e parë fjala “e marrësit” zëvendësohet me fjalët “e personit të thirrur”.
- b) Në paragrafin e dytë fjala “marrësi” zëvendësohet me fjalët “personi i thirrur” dhe fjalët “i thirruri është i mitur” zëvendësohen me fjalët “marrësi është i mitur”.
- c) Fjalja e fundit e paragrafit të katërt ndryshohet si më poshtë:

“Gjithashtu bëhet shënim në kopjen që mban nëpunësi i gjykatës edhe për marrëdhëniet e këtij personi me personin e thirrur, veprimet dhe kërkimet e bëra nga nëpunësi gjyqësor për dorëzimin e aktit personit të thirrur, si dhe vendin dhe kohën e dorëzimit.”.

Neni 12

Në nenin 133 bëhen këto ndryshime:

a) Në paragrafin e parë:

i) fjala “marrësi” zëvendësohet me fjalët “personi i thirrur”.

ii) Në fundit të tij shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Ky njoftim qëndron i afishuar për jo më pak se 20 ditë.”.

b) Në fund të nenit, shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Në rastin kur marrësi është person juridik privat, njoftimi bëhet nëpërmjet afishimit të tij pranë adresës së qendrës së regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ose në regjistrin e organizatave jofitimprurëse.

Në këto raste, njoftimi i aktit bëhet edhe në një rubrikë të posaçme në faqen zyrtare në internet të gjykatës, ose në një portal elektronik kombëtar të krijuar për këtë qëllim.”.

Neni 13

Neni 141 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 141

Rregullat e njoftimit elektronik të akteve

Njoftimi elektronik i akteve bëhet me mjete të komunikimeve elektronike, nëpërmjet dërgimit nga nëpunësi gjyqësor të letërthirrjes ose akteve të tjera që duhet t'i njoftohen personit të caktuar si marrës, në të dhënat e tij të kontaktit.

Ky njoftim duhet të pasqyrohet në një procesverbal të posaçëm, në të cilin duhet të tregohen të dhënat e kontaktit dhe mjeti i komunikimeve elektronike të përdorura për njoftim, data dhe ora e saktë e komunikimit, personi me të cilin komunikon dhe qëllimi i njoftimit.

Procesverbali hartohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhet prej tij dhe nëpunësit gjyqësor të ngarkuar për kryerjen e njoftimeve. Ky procesverbal bëhet pjesë e dosjes gjyqësore.

Rregulla të detajuara për mënyrën e njoftimit elektronik përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.”.

Neni 14

Neni 141/a dhe 142 shfuqizohen.

Neni 15

Neni 143 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 143

Në rastet kur njoftimi nuk mund të bëhet në rrugë shkresore dhe elektronike, zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 133 të këtij Kodi.”.

Neni 16

Neni 144 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 144
Mënyra të tjera njoftimi

Njoftimi mund të kryhet në çdo mënyrë tjetër që garanton një njoftim të rregullt për sa kohë që personi i thirrur konfirmon personalisht me shkrim se ka marrë njoftimin.”.

Neni 17

Në nenin 154 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Përveç këtyre kërkesave, paditësi në kërkesëpadi duhet të tregojë saktë:

a) të dhënat elektronike të kontaktit të tij ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, në të cilin gjykata mund ta njoftojë, si dhe deklaratën e pranimit të njoftimit me mjete të komunikimit elektronik;

b) listën e personave, që kërkon të thirren në gjykim, duke saktësuar emrin, atësinë, mbiemrin dhe adresën e plotë të tyre.

Paditësi, për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të dhënave elektronike të kontaktit të tij ose të përfaqësuesit, detyrohet të njoftojë gjykatën. Shkelja e këtij detyrimi i bën të papranueshme pretendimet për pavlefshmërinë e njoftimit.”.

Neni 18

Në nenin 158, paragrafi i katërt, fjalët “nenet 130 dhe 131” zëvendësohen me fjalët “kreun IV të titullit VI të pjesës I.”.

Neni 19

Në fund të nenit 158/a shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“I kërkon të paditurit ose personit të tretë të konfirmojë adresën, si dhe të japë të dhënat elektronike të kontaktit të tij ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, në të cilin gjykata mund ta njoftojë. Nëse i padituri ose personi i tretë pranon njoftimin elektronik, i kërkon të plotësojë deklaratën e pranimit të njoftimit me mjete të komunikimit elektronik. Për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të dhënave elektronike të kontaktit të tij ose të përfaqësuesit, i padituri ose personi i tretë detyrohet të njoftojë gjykatën. Shkelja e këtij detyrimi i bën të papranueshme pretendimet për pavlefshmërinë e njoftimit.”.

Neni 20

Neni 172 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 172

Shqyrtimi i çështjes përpara gjykatës bëhet verbalisht, por palët mund të parashtrajnë me shkrim shpjegimet dhe pretendimet e tyre rreth çështjes në gjykim.

Shpjegimet dhe pretendimet me shkrim të paraqitura nga palët, në mbështetje të kërkesave dhe konkluzioneve të tyre, bëhen pjesë e dosjes gjyqësore, ose i bashkohen procesverbalit kur ai mbahet me shtypshkrim apo dorëshkrim.”.

Neni 21

Në nenin 177, në fund të paragrafit të dytë shtohen fjalët “kur ai mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim.”.

Neni 22

Në nenin 211, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:
“Mosparaqitja e padisë brenda afatit të caktuar nga gjykata, e vërtetuar nga kryesekretari, shuan masën e sigurimit të padisë.”.

Neni 23

Në nenin 203, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Sigurimi i padisë nuk lejohet në rastet e padive që ngrihen gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit, për të cilat zbatohet pjesa e katërt e këtij Kodi.”.

Neni 24

Në nenin 206 paragrafi i parë, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:
“b) me anë të masave të tjera të përshtatshme të marra nga gjykata.”.

Neni 25

Në nenin 310, pas pikës 1 të paragrafit III shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:
“1/1. Nëse gjykata vendos detyrime për palët, përmbajtjen konkrete të tyre.”.

Neni 26

Pas nenit 310 shtohet neni 310/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 310/1

Vendimi i gjykatës, për të cilin duhet të lëshohet urdhër ekzekutimi, sipas pjesës së katërt të këtij Kodi, shoqërohet në çdo rast me kopjen e urdhrit të ekzekutimit, të përgatitur dhe nënshkruar nga gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues, që ka dhënë vendimin.

Kopja e urdhrit të ekzekutimit ruhet në sekretarinë gjyqësore dhe i njoftohet palëve, sipas rregullave të parashikuara në nenin 316, vetëm pasi vendimi merr formë të prerë dhe konfirmohet nga kancelari.

Nëse vendimi gjyqësor ndryshohet ose priset nga gjykata e apelit, kancelari urdhëron arkivimin, nëpërmjet një shënimi të posaçëm në kopjen e urdhrit të ekzekutimit, sipas rregullave të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.”.

Neni 27

Neni 316 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 316
Njoftimi i vendimeve

Vendimet përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, brenda tre ditëve nga marrja e vendimit ose, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tre ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar.

Njoftimi bëhet sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të pjesës I.”.

Neni 28

Neni 375 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 375
Kërkesa

Kërkesa për shpalljen e një personi të zhdukur ose të vdekur mund të paraqitet nga çdo person i interesuar, nga noteri, pranë të cilit personi ka redaktuar një testament me akt noterial, apo ka depozituar për ruajtje testamentin ollograf ose testamentin e posaçëm, apo nga prokurori në gjykatën ku ka pasur vendbanimin e fundit personi për të cilin kërkohet shpallja si i tillë.”.

Neni 29

Në nenin 380, paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Gjykata mund të marrë masa për sigurimin e pasurisë trashëgimore. Ajo autorizon dhomën e noterisë në nivel vendor, që mbulon njësinë vendore të vendbanimit të fundit të të shpallurit të zhdukur ose të vdekur, ose noterin, pranë të cilit është redaktuar testamenti me akt noterial, apo është depozituar për ruajtje testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm, që të bëjë inventarin e pasurisë së trashëgimlënësit. Dhoma e noterisë në nivel vendor cakton një noter për të bërë inventarin e pasurisë së trashëgimlënësit. Noteri në këtë rast duhet të caktojë një person si ruajtës të pasurisë trashëgimore deri në çeljen e dëshmisë së trashëgimisë.”.

Neni 30

Titulli IV i pjesës së dytë shfuqizohet.

Neni 31

Në nenin 447, fjalët “nenet 130 dhe 131” zëvendësohen me fjalët “kreun IV të titullit VI të pjesës I.”.

Neni 32

Në nenin 445, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Ankimi në gjykatën e apelit dhe rekursi në Gjykatën e Lartë nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit.”.

Neni 33

Pas nenit 466 shtohet neni 466/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 466/1

Vendimi i Gjykatës së Apelit, i cili ndryshon një vendim të gjykatës së shkallës së parë, për të cilin duhet të lëshohet urdhër ekzekutimi, sipas pjesës së katërt të këtij Kodi, shoqërohet në çdo rast me urdhrin e ekzekutimit, të nënshkruar nga kryetari i trupit gjykues që ka dhënë vendimin.

Urdhri i ekzekutimit dorëzohet në sekretarinë gjyqësore dhe pasi konfirmohet nga kancelari, i njoftohet gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin e ndryshuar, si dhe palëve, sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të pjesës I.”.

Neni 34

Në nenin 467 paragrafi i parë bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) përbërja e trupit gjykues nuk ka qenë e rregullt apo vendimi nuk është nënshkruar nga anëtarët e tij, ose është cenuar parimi i paanësisë.”.

b) Shkronja “ë” ndryshohet si më poshtë:

“ë) lind nevoja për marrjen e një prove vendimtare, marrja e së cilës është e vështirë në shkallë të dytë, ose gjykata nuk është shprehur për të gjitha kërkesat e parashtruara nga palët në padi dhe që përbëjnë objektin e mosmarrëveshjes midis palëve ndërgjyqëse.”.

Neni 35

Në nenin 472, shkronja “c” e paragrafit të parë shfuqizohet.

Neni 36

Neni 480 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 480

Mospranimi i rekursit

Mospranimi i rekursit vendoset në dhomë këshillimi, në kolegji me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë, në rastet kur:

a) bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji;

b) nuk plotësohen kërkesat procedurale të parashikuara në këtë kre;

c) pala që ka paraqitur rekurs heq dorë prej tij.

Pala kundër së cilës është paraqitur rekursi, mund të paraqesë kundërshtimet e saj sipas rregullave të parashikuara në nenin 477 të këtij Kodi.

Shqyrtimi bëhet brenda 60 ditëve nga depozitimi i rekursit, pa praninë e palëve, por pasi janë shqyrtuar pretendimet me shkrim të tyre për çështjen e pranueshmërisë.

I njëjti trup gjykues vendos për çdo kërkesë procedurale të palëve, me përjashtim të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit.”.



Neni 37

Në nenin 482, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Gjykata e Lartë gjykon në kolegji me trup gjykues të përbërë nga tre ose pesë gjyqtarë, sipas rregullave të parashikuara në nenin 35.”.

Neni 38

Neni 511 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 511

Urdhri i ekzekutimit

Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, i cili:

a) për rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 510 të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin. Në këtë rast, kancelari konfirmon urdhrin e ekzekutimit, brenda pesë ditëve nga marrja formë të prerë e vendimit gjyqësor;

b) për vendimet e gjykatave të shteteve të huaja e të gjykatave të arbitrazhit të huaj, që u është dhënë fuqi në zbatim të dispozitave të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata e apelit brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit;

c) për rastet e parashikuara nga shkronja “ç” e nenit 510 të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata e vendit ku është dhënë vendimi brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit;

ç) për rastet e parashikuara nga shkronjat “d”, “dh” dhe “e”, lëshohet nga gjykata e vendit ku detyrimet që përmban titulli ekzekutiv do të përmbushen, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit.

Nuk lëshohet urdhri i ekzekutimit për vendimin e sigurimit të padisë dhe për gjobat e dhëna nga gjykata, si dhe për vendimet civile të gjykatës, të dhëna për ekzekutim të përkohshëm, të cilat ekzekutohen drejtpërdrejt nga zyra e përmbartimit, pas njoftimit të vendimit.”.

Neni 39

Pas nenit 511 shtohet neni 511/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 511/1

Për rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 510 të këtij Kodi, urdhri i ekzekutimit lëshohet së bashku me vendimin gjyqësor dhe bëhet i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor vetëm pas konfirmimit nga kancelari.

Kancelari konfirmon urdhrin e ekzekutimit vetëm pasi verifikon se vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë.

Ky konfirmim bëhet nëpërmjet një shënimi të posaçëm në urdhrin e ekzekutimit, sipas rregullave të përcaktuara me urdhër të Ministrisë së Drejtësisë.”.

Neni 40

Në nenin 517, paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Me kërkesë të debitorit gjykata e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit, në raste të veçanta, duke marrë parasysh gjendjen pasurore të debitorit ose rrethana të tjera të çështjes dhe pasi të dëgjojë kreditorin, mundet të shtyjë afatin e ekzekutimit të detyrimit në të holla ose të ndajë këtë 2998

detyrim në këste, përveç rasteve kur ky detyrim rrjedh nga një akt për dhënien e kredisë bankare. Vendimi jepet në seancë gjyqësore, brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe kundër tij mund të bëhet ankim i veçantë.”.

Neni 41

Në nenin 564, fjalia e fundit e paragrafit të dytë ndryshohet si më poshtë:

“Kundër vendimit të përmbaruesit palët mund të bëjnë ankim, sipas rregullave të parashikuara në nenin 610 të këtij Kodi.”.

Neni 42

Në nenin 568, në fund të fjalisë së parë të paragrafit të parë shtohen fjalët “si dhe për 5 ditë me radhë në dy gazeta kombëtare me tirazhin më të madh”.

Neni 43

Në nenin 577, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij, përmbaruesi gjyqësor përcakton çmimin e ri të sendit, jo më të ulët se 30 për qind të çmimit fillestar të caktuar në ankandin e parë. Ankandi i dytë për shitjen e sendit bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 568 të këtij Kodi dhe zhvillohet 30 ditë nga e nesërmyja e datës së caktimit të çmimit të ri.”.

Neni 44

Në nenin 609 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Në këto raste, gjykata mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare, gjykata mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit, vetëm me garanci dhe për një periudhë jo më shumë se 3 muaj, përveç rasteve kur gjykata, brenda këtij afati, vendos me vendim përfundimtar pranimin e padisë. Me kalimin e afatit 3-mujor, ose kur gjykata, brenda këtij afati, vendos refuzimin e padisë ose pushimin e gjykimit të saj, masa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit konsiderohet e rënë nga fuqia.”.

b) Pas paragrafit të tretë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Gjykata shqyrton kërkesat, sipas këtij neni, brenda 5 ditëve. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.”.

Neni 45

Në fund të nenit 610 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit.

Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.”.



Neni 46

Neni 611 shfuqizohet.

Neni 47

Në nenin 615, shkronja “a” e paragrafit të parë ndryshohet si më poshtë:
“a) me vendim të gjykatës në rastet e parashikuara nga ligji;”.

Neni 48

Në nenin 616, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë vijon:
“c) kur gjykata deklaron, me një vendim gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 609 të këtij Kodi, se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël, ose është shuar më pas.”.

Neni 49

Dispozitë kalimtare

Çështjet civile që janë në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të gjykoen sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesë-padisë.

Neni 30 i këtij ligji hyn në fuqi pas miratimit të ligjit për arbitrazhin.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të paraqesë në Kuvend, për shqyrtim dhe miratim, projektligjin që rregullon arbitrazhin vendas dhe ndërkombëtar.

Ngarkohet Ministri i Drejtësisë të nxjerrë aktet nënligjore brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 50

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 shtator 2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8131, datë 30.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

VENDIM Nr. 20/2013

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Ekspertit Përzgjedhës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Abaz Aliko emërohet anëtar i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 25.4.2013

VENDIM
Nr. 21/2013

PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT LULZIM LELÇAJ ANËTAR
TË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 147 të Kushtetutës, të nenit 4 pikat 2 dhe 7 të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Lulzim Lelçaj zgjidhet anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 25.4.2013

VENDIM
Nr. 22/2013

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZOTIT
ADMIR THANZA ANËTAR I GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8115, datë 19.4.2013,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Admir Thanza anëtar i Gjykatës së Lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 25.4.2013

VENDIM
Nr. 23/2013

**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZOTIT
TOM NDRECA ANËTAR I GJYKATËS SË LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8116, datë 19.4.2013,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Tom Ndreca anëtar i Gjykatës së Lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 25.4.2013

VENDIM
Nr. 24/2013

**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN
E ZOTIT XHEZAIR ZAGANJORI KRYETAR I GJYKATËS SË LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 2 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8120, datë 24.4.2013,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Xhezair Zaganjori Kryetar i Gjykatës së Lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 25.4.2013

VENDIM
Nr. 25/2013

**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZOTIT FATOS LULO
ANËTAR I GJYKATËS KUSHTETUESE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 125 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8121, datë 24.4.2013,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Fatos Lulo anëtar i Gjykatës Kushtetuese.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 25.4.2013

UDHËZIM
Nr. 1, datë 3.5.2013

PËR DHËNIEN ME QIRA TË MONUMENTEVE TË KULTURËS

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 784-804 e në vazhdim, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore" të ndryshuar, si dhe në vijim të pikës 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.529, datë 8.6.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore",

UDHËZOJ:

I. Monumentet e kulturës që rijetëzohen, kriteret e konkurrimit e drejta, kompetencat dhe afatet

1. Monumentet e kulturës rijetëzohen për qëllime administrative dhe social-kulturore, me kusht që funksioni i ri të mos dëmtojë vlerën e monumentit nëpërmjet procedurës së konkurrimit. Përfshihen nga konkurrimi dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 (dyqind) m², të cilat jepen me afat nga 1 deri në 5 vjet.

Afati i lidhjes së kontratës së qirasë për rijetëzimin e monumentit përcaktohet rast pas rasti nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit, për sipërfaqe mbi 200 (dyqind) – 500 (pesëqind) m² është deri në 10 vjet ndërsa për sipërfaqe mbi 500 (pesëqind) m² është deri në 20 vjet.

2. Kriteret e vlerësimit të konkurrimit në rijetëzimin e monumenteve të kulturës janë si më poshtë vijon:

- a) Planin e biznesit;
- b) Niveli i punësimit sipas termave të planbiznesit të propozuar;
- c) Eksperienca të mëparshme të subjektit hartues të projektit në restaurim;



- d) Cilësia e prezantimit të projektit;
- e) Vlera e qirasë së ofruar për njësi sipërfaqeje.

3. Të drejtën e lidhjes së kontratës së rijetëzimit të monumentit e ka MTKRS, me një afat që do të vendoset rast pas rasti prej saj.

II. Procedurat që ndiqen për rijetëzimin e monumenteve të kulturës

1. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për monumentin që rijetëzohet, përgatit dokumentacionin, si vijon:

a) Propozimin nga institucionet e specializuara për rijetëzimin e monumentit, i cili përmban edhe objektin e veprimtarive që mund të ushtrohen në monument së bashku me projektin e rijetëzimit të miratuar nga KKR/KKA.

b) Genplanin e objektit, ku të jetë shënuar sipërfaqja e truallit gjithsej, sipërfaqja e truallit nën ndërtesë dhe sipërfaqja e truallit të lirë funksional (jo nën ndërtesë) të konfirmuar nga IMK-ja.

c) Vlerën dysheme të detyrimit mujor sipas kreut III pika 1/a dhe b të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.529, datë 8.6.2011 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore".

Pas përgatitjes së dokumentacionit, përgatitet urdhri i titullarit për shpalljen e procedurave për dhënien për rijetëzim.

2. Urdhri i titullarit të institucionit, për rijetëzimin me konkurrim, të monumentit të kulturës, me këtë përmbajtje:

a) Të dhënat e objektit: emërtimi, sipërfaqja, qëllimi i përdorimit, çmimi dysheme, afati.

b) Aktiviteti që mund të ushtrohet në objekt.

c) Pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, të përcaktuara sipas pikës 2 të kapitullit I të këtij udhëzimi, të cilat caktohen, rast pas rasti, nga titullari i institucionit;

ç) Vendi, data dhe ora ku paraqiten dokumentet e konkurruesve.

d) Përbërja e komisionit të ndjekjes së procedurave të rijetëzimit të konkurrentëve.

dh) Dokumentacioni që do të paraqitet në konkurrim nga konkurrentët.

Këtij urdhri i bashkëlidhet edhe njoftimi për botim.

3. Njoftimi për botim për rijetëzimin e monumentit të kulturës shpallet 2 herë në buletin shtetëror të njoftimeve dhe përmban: të dhënat për objektin, kategorizimin e aktivitetit, pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, dokumentacionin që do të paraqitet nga konkurrentët, si dhe vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrimit të jetë jo më parë se 15 ditë kalendarike pas datës së fundit të publikimit.

4. Dokumentacioni për rijetëzimin e monumentit të kulturës, që duhet të paraqesin konkurrentët, i dorëzohet komisionit dhe përmban:

a) Kërkesën e subjektit për rijetëzimin e monumentit të kulturës;

b) Planbiznesin e detajuar, për vënien në funksionim të monumentit të kulturës, ku të përshkruhet qartë plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen;

c) Ofertën për tarifën mujore të qirasë;

d) Certifikatën e regjistrimit të subjektit në QKR ose vendimin e regjistrimit në gjykatë;

e) Vërtetim nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;

f) Vërtetim që subjekti konkurrues nuk është në ndjekje penale;

g) Vërtetim që subjekti konkurrues nuk është në proces gjyqësor për çështje që kanë të bëjnë me ushtrimin e aktivitetit.

h) Vërtetim bankar që subjekti ka kapacitet financiare për mbulimin e investimit.

5. Komisioni i ndjekjes së procedurave përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë dhe ka në përbërje të tij një ekonomist, një jurist, një inxhinier ose arkitekt, dy specialistë të fushës nga institucione të specializuara, siç përcaktohet në pikën 12 të nenit 3 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar.

6. Komisioni i ndjekjes së procedurave për rijetëzimet e monumenteve të kulturës kryen këto detyra:

a) Bën protokollimin e kërkesave dhe hap në prani të konkurrentëve dokumentacionin e paraqitur prej tyre. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, konkurrenti skualifikohet në prani të tij.

Komisioni lexon dhe bën të njohur, në prani të konkurrentëve të kualifikuar për pjesëmarrje në konkurrim, të dhënat kryesore e për çdo ofertë të paraqitur.

b) Harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrimin, ku përshkruan pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe shkakun, konkurrentët e kualifikuar dhe listën e dokumenteve të paraqitura prej tyre.

c) Brenda 5 ditëve i paraqet Këshillit Kombëtar të Restaurimit një raport përmbledhës për zhvillimin e konkurrimin dhe të gjithë dokumentacionin përkatës, së bashku me procesverbalin e zhvillimit të konkurrimin dhe listën e konkurruesve të kualifikuar.

7. KKR-ja pas shqyrtimit të projekteve të paraqitura, vlerëson me pikë çdo element konkurrimi, sipas përcaktimit në urdhrin e titullarit.

Subjektet vlerësohen me sistem pikësh për çdo element sipas kësaj renditjeje:

a) Niveli i argumentuar i investimit dhe i punësimit;

b) Shkalla e shndërrimit të monumentit në një qendër të promovimit të historisë dhe kulturës;

c) Parametrat për infrastrukturën dhe elementet e vizitueshmërisë të lidhura me monumentin (rrugë, ndriçim, tabela etj.);

d) Niveli i qirasë.

Në përfundim, konkurruesit renditen në bazë të pikëve të përfituara. Këshilli Kombëtar i Restaurimit vendos për subjektin fitues të konkurrimin. Subjekti fitues njoftohet me shkrim mbi vendimin e Këshillit Kombëtar të Restaurimit dhe është i detyruar të zbatojë vërejtjet teknike të Këshillit Kombëtar të restaurimeve, të cilat do t'i bëhen me dije. Njoftimi për shpalljen fitues vendoset në këndin e njoftimeve të MTKRS-së.

8. Subjektet konkurruese, brenda 5 ditëve nga shpallja e subjektit fitues, kanë të drejtën e ankimit te ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, i cili brenda 10 ditësh i përgjigjet ankuesit me shkrim; vendimi i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore është përfundimtar.

9. Pas përfundimit të procedurave të mësipërme, komisioni i ndjekjes së procedurave të rijetëzimit, fillon procedurat për hartimin dhe lidhjen e kontratës së shfrytëzimit e rijetëzimit të monumentit të kulturës.

10. Para nënshkrimit të kontratës së shfrytëzimit e rijetëzimit, subjekti është i detyruar të kryejë pagesën e garancisë së kontratës. Garancia rri e ngurtësuar deri në fund të kontratës.

III. Nxitja e biznesit

1. Për monumentet e kulturës, që jepen me qira me sipërfaqe mbi 200 m², vlera e detyrimit mujor rillogaritet me zbritje, kur subjekti që ka marrë me qira vërteton se ka plotësuar kriteret e mëposhtme:

a) Për punësimin mesatar vjetor, të vërtetuar nga dega e sigurimeve shoqërore:

i) kur punësohen 5 - 15 veta, zbritja është 10 për qind;

ii) kur punësohen 16 - 25 veta, zbritja është 20 për qind;

iii) kur punësohen mbi 26 veta, zbritja është 30 për qind;

b) Për investimet e kryera:

i) 5 000 000 (pesë milionë) lekë deri në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, zbritja është 15 për qind;

ii) 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë deri në 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë, zbritja është 25 për qind;



iii) mbi 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë, zbritja është 35 për qind. Ulja e vlerës së detyrimit mujor zbatohet si shumë e të dyja kriterëve të mësipërme.

2. Ulja e vlerës së detyrimit mujor nga realizimi i investimeve vlen deri në përfundimin e afatit të kontratës së qirasë, ndërsa ulja e vlerës së detyrimit mujor nga niveli i punësimit vlen për 1 (një) vit, në funksion të vërtetimit vjetor të punësimit, të lëshuar nga institucionet shtetërore përkatëse.

3. Për përfitim të zbritjes së detyrimit mujor, qiramarrësi i paraqet ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin:

a) Vërtetim për punësimin mesatar vjetor të realizuar në vitin përkatës, lëshuar nga institucionet shtetërore përkatëse;

b) Raport i ekspertit kontabël për investimet e realizuara nga qiramarrësi në objektin e marrë me qira dhe të paraqitura në bilancet financiare të shoqërisë qiramarrëse;

c) Bilancin financiar të shoqërisë qiramarrëse për vitin përkatës, të dorëzuar në degën e tatimeve.

4. Vlëra e qirasë, si dhe vlëra e investimeve të kryera llogariten çdo vit vazhdues sipas normës së inflacionit të shpallur nga Banka e Shqipërisë.

IV. Kontratat e rijetëzimit

1. Kontrata e rijetëzimit për sipërfaqe deri në 200 m² për një afat 1-vjeçar nënshkruhet nga institucioni që ka në varësi administrative monumentin, për një afat deri në 5 vjet me miratim të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Kontratat mbi 200 m² nënshkruhen nga Ministri i Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve.

2. Monitorimi i kontratës së nënshkruar bëhet nga Instituti i Monumenteve të Kulturës të paktën dy herë në vit, dhe ka këto detyra:

a) Me lidhjen e kontratës së qirasë, bëhet dorëzimi me procesverbal i objektit të përshkruar në kontratë, si dhe e merr atë në dorëzim kur mbaron afati i kontratës ose kur kontrata zgjidhet para afatit. Në procesverbal përshkruhet qartë gjendja fizike e pronës dhe shoqërohet me pamje fotografike të çastit.

b) Ndjek në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratës së qirasë dhe raporton pranë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Institucioni që ka në administrim objektin raporton çdo tre muaj te ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, për realizimin e derdhjeve të detyrimeve të qirasë dhe të treguesve të tjerë, për kontratat e lidhura, sipas pikës 3 të kapitullit I të këtij udhëzimi, shoqëruar me mandatpagesat dhe çdo dokumentacion tjetër, të vlefshëm.

4. Çdo ndryshim i kushteve të kontratës, i kërkuar nga kontraktuesi, bëhet me miratimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

5. Të ardhurat, që krijohen nga dhënia me qira e monumenteve të kulturës ndahen, si më poshtë vijon:

- 10 për qind Buxheti i Shtetit;

- 90 për qind institucioni që ka në administrim objektin.

6. Zbatimi i projektit sipas vendimit të KKR-së do të kryhet nga subjekte të licencuara, kolaudimi do të bëhet nga specialistë të IMK-së në përputhje me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.426, datë 13.7.2007 "Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit". Specialistët do të shpërblehen në masën e caktuar në kontratë të veçantë lidhur mes subjektit fitues dhe kolaudatorit.

7. Të gjitha subjektet që kanë marrë për shfrytëzim me qira me afat 1-vjeçar monumente kulture, në rast se afatet e kontratës kanë mbaruar, duhet të bëjnë kërkesë për përdorimin e monumenteve të kulturës pranë MTKRS.

8. Udhëzimi nr. 1829, datë 17.3.2011 "Për dhënien me qira ose enfitozë për shfrytëzimin e monumenteve të kulturës" revokohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE
Visar Zhiti

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 3.5.2013
Doli nga shtypi më 3.5.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 42 lekë